



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 23 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin në Listën e Provave Materiale të
Pesë Materialeve në lidhje me Dëshmitarin Ekspert**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Panel"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe (6) dhe 40 të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 95(4)(c), 102(1)(b), 118(2), dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykses lëshoi Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit,¹ në të cilin urdhëronte Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") që "të sigurohet para fillimit të çështjes që aktekspertiza e çdo eksperti që synon të thërrasë të finalizohet dhe të jetë gati për tu paraqitur si provë".²
2. Më 16 mars 2023, pas autorizimit nga Trupi Gjykses,³ ZPS-ja dorëzoi listën e ndryshuar të provave materiale ("Lista e Provave Materiale").⁴
3. Më 29 mars 2023, ZPS-ja dorëzoi kërkesën për shtimin në listën e provave materiale të pesë materialeve në lidhje me dëshmitarin ekspert W04875 ("Kërkesa").⁵ Ekippet e Mbrojtjes për katër të akuzuarit nuk dorëzuan përgjigje ndaj Kërkesës.
4. Më 3 prill 2023, filloi gjykimi.⁶

¹ F01226, Trupi Gjykses, *Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, me Shtojcën 1 ("Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit").

² Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 122.

³ F01352, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Çështje të lidhura me Të* ("Vendimi i 8 marsit 2023"), 8 mars 2023, konfidencial.

⁴ F01376, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale*, 16 mars 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

⁵ F01405, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Shtimin në Listën e Provave Materiale të Pesë Materialeve në lidhje me Dëshmitarin Ekspert*, 29 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-5, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 12 prill 2023, F01405/RED).

⁶ Transkripti i seancës, 3 prill 2023, publik.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja kërkon leje për ndryshimin e Listës së Provave Materiale për të përfshirë dokumentet në vijim në lidhje me dëshmitarin ekspert W04875 (së bashku, “provat materiale shtesë”): (i) aktekspertizën mjekoligjore të përditësuar të ADN-së (“Aktekspertiza e Plotësuar e W04875-ës”⁷) të përgatitur nga W04875 më 6 mars 2023 për të plotësuar aktekspertizën e tij të parë të vitit 2021⁸ në lidhje me, midis të tjerash, identifikimin përmes ADN-së të vitit 2009⁹; (ii) letrën me udhëzime që ZPS-ja i dha W04875-ës para përpilimit të Aktekspertizës së Plotësuar të W04875-ës;¹⁰ (iii) një analizë të përditësuar të ADN-së në lidhje me një viktimë të vrasjes së paligjshme të përmendur me emër në Aktakuzë (përkatësisht, “Aktekspertiza e Përditësuar e ADN-së” dhe “viktima e pretenduar e vrasjes së paligjshme”), të dhënë nga W04875 dhe që përmban gjasën e llogaritur sërish të identifikimit përmes ADN-së të viktimit të pretenduar të vrasjes së paligjshme;¹¹ (iv) një shënim zyrtar në lidhje me një shkëmbim mesazhesh elektronike me W04875-ën, që jep informacion shtesë për dëshminë e tij si ekspert në lidhje me Aktekspertizën e Përditësuar të ADN-së (“Qartësimi i W04875-ës”);¹² dhe (v) procesverbalin zyrtar të takimit të 15 marsit 2023 që përmban informacion relevant për Aktekspertizën e Përditësuar të ADN-së, Aktekspertizën e Plotësuar të W04875-ës, dhe Aktekspertizën e Vitit 2021 (“Procesverbali i Takimit të 15 Marsit 2023”¹³).¹⁴

6. ZPS-ja argumenton se: (i) Kërkesa duhet të trajtohet me fleksibilitet pasi çështja gjyqësore ka të bëjë me disa të akuzuar dhe me një sasi të madhe provash; dhe (ii) duke pasur parasysh fazën e procesit, kuadrin e çështjes, dhe natyrën e

⁷ Shtojca 1 e Kërkesës.

⁸ Materiali ERN 103373-103387.

⁹ Materiali ERN SITF00012453-SITF00012464.

¹⁰ Shtojca 2 e Kërkesës.

¹¹ Shtojca 3 e Kërkesës.

¹² Shtojca 4 e Kërkesës.

¹³ Shtojca 5 e Kërkesës.

¹⁴ Kërkesa, para. 1, 16.

kufizuar të Provave Materiale Shtesë, pasojat për përgatitjen e Mbrojtjes janë minimale.¹⁵ ZPS-ja parashtron se Kërkesa është paraqitur brenda afatit pasi: (i) u bë para fillimit të gjykimit dhe në kohë të mjaftueshme para dëshmisë së W04875-ës (i cili nuk pritet të jetë në mesin e 40 dëshmitarëve të parë); dhe (ii) garanton që aktekspertiza e W04875-ës do të përfundohet dhe do të jetë gati për t'u paraqitur si provë.¹⁶

7. ZPS-ja gjithashtu parashtron se ekzistojnë arsye bindëse për provat materiale shtesë pasi ato janë relevante *prima facie* dhe të rëndësishme të mjaftueshme për të arsyetuar përfshirjen e tyre në Listën e Provave Materiale.¹⁷

III. DISKUTIM

8. Në bazë të rregullës 118(2), Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse, në fazën e tashme të procesit, ZPS-ja ka njoftuar në kohë dhe ka dhënë arsye të vlefshme për provat materiale shtesë, dhe nuk i shkaktohet asnjë dëm Mbrojtjes me ndryshimin e listës së provave materiale të ZPS-së.¹⁸

9. Sa i përket njoftimit brenda afatit, Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se: (i) Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi afatin për parashtrimin e listës së provave materiale të ZPS-së dhe miratoi një numër ndryshimesh të saj;¹⁹ dhe

¹⁵ Kërkesa, para. 4. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 12, 14.

¹⁶ Kërkesa, para. 2, 5-7. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 13.

¹⁷ Kërkesa, para. 2, 9-11.

¹⁸ *Shih* Vendimin në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 16; ICTY, *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-T, Decision on Fifth Defence Motion for Leave to Amend its Rule 65 *ter* Exhibit List ("[Hadžić Decision](#)"), 19 February 2015, para. 5; [Karadžić Decision](#), para. 9; *Prosecutor v. D. Milošević*, IT-98-29/1-T, [Decision on Prosecution's Third Motion for Leave to Amend Its Rule 65 ter Exhibit List](#), 23 April 2007, p. 3; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, [Decision allowing the Prosecution to Add to Its Exhibit List a Statement by Mr Andrew Donaldson \(Witness PRH230\)](#), 28 April 2017, para. 18.

¹⁹ Transkripti i seancës, 29 tetor 2021, f. 752-753; F00667, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Zgjatje Afati*, 31 janar 2022, konfidencial, para. 13 (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00667/RED). *Shih gjithashtu* F00727, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse*, 8 mars 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 54 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua në të njëjtën ditë, F00727/CONF/RED);

(ii) Trupi Gjykses tashmë e ka miratuar ndryshimin e Listës së Provave Materiale të ZPS-së.²⁰ Sidoqoftë, gjatë vlerësimit nëse Kërkesa është bërë brenda afatit, Trupi Gjykses vë në dukje se provat materiale shitesë përmbajnë materiale që janë krijuar ose janë marrë nga ZPS-ja pak kohë më parë.

10. Konkretisht, Trupi Gjykses vëren se: (i) më 15 shkurt 2023, ZPS-ja e udhëzoi W04875-ën të paraqiste një plotësues të aktekspertizës së parë të vitit 2021 për të dhënë mendimin si ekspert në lidhje me Aktekspertizën e Përditësuar të ADN-së për viktimën e pretenduar të vrasjes së paligjshme, menjëherë pasi mësoi nga eksperti që kishte përpiluar identifikimin e parë përmes ADN-së në vitin 2009 dhe kishte shkruar Aktekspertizën e Përditësuar të ADN-së se tani ekzistonin metoda statistikore që ishin më të mira se ato të përdorura për identifikimin përmes ADN-së në vitin 2009;²¹ (ii) më 6 mars 2023, ZPS-ja mori Aktekspertizën e Plotësuar të W04875-ës dhe Qartësimin e W04875-ës;²² dhe (iii) më 15 mars 2023, ZPS-ja mori informacionin që përmban Procesverbali i Takimit të 15 Marsit 2023.²³ Trupi Gjykses gjithashtu gjykon se, në përputhje me Urdhrin mbi Zhvillimin e

F00779, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesave në lidhje me Të, 22 prill 2022*, konfidencial, para. 55; F00876, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse, 8 korrik 2022*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 107 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua në të njëjtën ditë, F00876/CONF/RED); F00957, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse, 6 shtator 2022*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 107 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 7 shtator 2022, F00957/CONF/RED); F01057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Parashtrimin e Prokurorisë sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat lidhur me Të, 27 tetor 2022*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 58 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua në të njëjtën ditë, F01057/CONF/RED); F01058, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Dy Dëshmitarëve dhe Materialeve lidhur me Ta, 27 tetor 2022*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 47 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua në të njëjtën ditë, F01058/CONF/RED); F01142, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe për Masa Mbrojtëse, 6 dhjetor 2022*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 304 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 7 dhjetor 2022, F01142/CONF/RED).

²⁰ Vendimi i 8 Marsit 2023, para. 36.

²¹ Shtojcat 2-3 të Kërkesës. *Shih gjithashtu Kërkesën*, para. 6.

²² Shtojcat 1, 4 të Kërkesës.

²³ Shtojca 5 e Kërkesës.

Gjykimit,²⁴ Kërkesa u dorëzua para fillimit të gjykimit më 3 prill 2023. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se Kërkesa është bërë brenda afatit.

11. Sa u përket arsyeve të vlefshme, Trupi Gjykses vë në dukje se leja për ndryshimin e listës së provave materiale nuk duhet të miratohet për materialet që duket qartë se nuk janë relevante dhe, rrjedhimisht, do të refuzohet paraqitja e tyre si prova.²⁵ Ky vlerësim nuk do të thotë se duhet të shqyrtohet pranueshmëria e materialit të propozuar, po duhet të bëhet vetëm vlerësimi *prima facie*. Trupi Gjykses mund të marrë gjithashtu parasysh faktorë të tjerë që janë në favor apo kundër shtimit të kërkuar, përfshirë në qoftë se provat e propozuara janë relevante *prima facie* dhe me vlerë provuese për akuzat kundër të akuzuarit, kompleksitetin e çështjes, hetimet në kryerje e sipër, dhe përkthimin e dokumenteve dhe materialeve të tjera.²⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses do të balancojë me kujdes çdo ndryshim të listës së provave materiale të Prokurorisë me mbrojtje përkatëse të të drejtave të të akuzuarve.²⁷ Me fjalë të tjera, Trupi Gjykses duhet të bindet se ndryshimet e listës së provave materiale në atë fazë të procesit i janë bërë të njohura të akuzuarit kohë të mjaftueshme përpara dhe nuk ndikojnë negativisht në aftësinë e tij për t'u përgatitur për gjykim.²⁸

12. Pasi shqyrtimit të kujdesshëm të provave materiale shtesë, Trupi Gjykses konstaton se ato janë relevante *prima facie* dhe të rëndësishme në masë të mjaftueshme për të arsyetuar shtimin e vonuar për aq sa përmbajnë ose kanë lidhje të ngushtë me mendimin plotësues të dëshmitarit ekspert për Aktekspertizën e

²⁴ Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 122.

²⁵ Vendimi në *Çështjen Gucati dhe Haradinaj*, para. 16. *Shih gjithashtu* ICTY, [Karadžić Decision](#), para. 10; [Hadžić Decision](#), para. 5; *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-03-69-T, Decision on Prosecution Motion for Leave to Amend its Rule 65 *ter* Exhibit List (“*Stanišić and Simatović Decision*”), 8 May 2008, para. 7; *Prosecutor v. Delić*, IT-04-83-T, [Decision on Urgent Prosecution Motion for Leave to Amend its Exhibit List](#), 17 October 2007, p. 4; *Prosecutor v. Bošković and Tarčulovski*, IT-04-82-T, [Decision on Tarčulovski Motion for Permission to Add Additional Exhibits to its 2D Defence Exhibit List](#), 12 March 2008, para. 3.

²⁶ ICTY, [Karadžić Decision](#), para. 9 (and authorities cited therein).

²⁷ ICTY, *Stanišić and Simatović Decision*, para. 6; [Karadžić Decision](#), para. 9.

²⁸ ICTY, *Stanišić and Simatović Decision*, para. 6; [Karadžić Decision](#), para. 9.

Përditësuar të ADN-së në lidhje me një viktimë të pretenduar të vrasjes së paligjshme që është përmendur me emër në Aktakuzën e Ndryshuar.²⁹

13. Sa i përket ndikimit të provave materiale shtesë në përgatitjen e të akuzuarve për gjykim, Trupi Gjykes vë në dukje se: (i) aktekspertiza e parë e W04875-ës e vitit 2021 tashmë është nxjerrë për Mbrojtjen;³⁰ (ii) W04875 nuk është në mesin e 40 dëshmitarëve të parë që do të dëshmojnë;³¹ (iii) provat materiale shtesë kanë të bëjnë me një aspekt të njohur të argumenteve të ZPS-së, përfshirë një dëshmitar ekspert në listën e dëshmitarëve, provat materiale në listën e provave materiale,³² dhe një qendër të njohur ndalimi dhe viktimën e pretenduar të vrasjes së paligjshme; dhe (iv) provat materiale shtesë përmbajnë gjithsej vetëm 18 faqe.

14. Siç është vënë në dukje, Mbrojtja u njoftua për shtimin e provave materiale shtesë në Listën e Provave Materiale para fillimit të gjyimit dhe do të ketë kohë të mjaftueshme të ekzaminojë materialin në fjalë. Trupi Gjykes vë në dukje gjithashtu se dëshmitari përkatës me të cilin lidhet materiali ende nuk është caktuar të dëshmojë, që do t'i japë Mbrojtjes kohë të mjaftueshme të shqyrtojë atë material dhe të përgatitet për dëshminë e tij në lidhje me këtë material të ri. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes është bindur se Mbrojtja ka marrë informacion të mjaftueshëm dhe i është dhënë kohë e përshtatshme për përgatitje sa u përket provave materiale shtesë.

15. Për këto arsye, Trupi Gjykes konstaton se ZPS-ja ka dhënë njoftim të mjaftueshëm para kohe, ka treguar arsye të vlefshme për provat materiale shtesë, dhe ka treguar se Mbrojtja nuk do të dëmtohet prej shtimit të provave materiale

²⁹ F00999, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, me Shtojcat 1 ("Aktakuza e Ndryshuar"), 2, konfidenciale, dhe Shtojcën 3, publike.

³⁰ *Shih* Paketat 117, 657 të Materialit të Nxjerrë .

³¹ F01117, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës Paraprake të 40 Dëshmitarëve të Parë që do të Thirren në Gjykim*, 18 nëntor 2022, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

³² *Shih* Aktekspertizën e Vitit 2021; Lista e Provave Materiale, Materiali 4440; Identifikimi përmes ADN-së i vitit 2009; Lista e Provave Materiale, materiali 6702.

shtesë në Listën e Provave Materiale të ZPS-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton shtimin e provave materiale shtesë në listën e provave materiale të ZPS-së dhe urdhëron ZPS-në të dorëzojë listën e provave materiale të ndryshuar deri të martën, 30 maj 2023. Trupi Gjykses gjithashtu urdhëron ZPS-në të nxjerrë provat materiale shtesë sipas rregullës 102(1)(b)(ii)-(iii) deri të martën, 30 maj 2023.

IV. VENDIM

16. Për arsyet e lartpërmendura Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b) **AUTORIZON** ZPS-në të shtojë provat materiale shtesë në Listën e Provave Materiale dhe **URDHËRON** ZPS-në që të: (i) dorëzojë Listën e Provave Materiale të ndryshuar deri të martën, 30 maj 2023; dhe (ii) të nxjerrë provat materiale shtesë për Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave deri të martën, 30 maj 2023.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 23 maj 2023

Në Hagë, Holandë.